



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	13.07.2026
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Qershor

I nderuar Kryetar z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.06.2026 deri me 30.06.2026

Lipjan 2026

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë kësaj periudhe, fokusi ka qenë në zbatimin e planit të punës, mbështetjen e fermerëve, realizimin e projekteve dhe subvencioneve, si dhe koordinimin e aktiviteteve të përditshme në funksion të realizimit të projekteve në sektorin e bujqësisë.

Gjatë muajit qershor janë zhvilluar takime me përfaqësuesit e organizatës Qatar Charity, ku është diskutuar për realizimin e projekteve të deritanishme, si dhe janë planifikuar projekte të reja. Pritet që shumë shpejt të nënshkruhen memorandumet e bashkëpunimit për zbatimin e këtyre projekteve.

Në muajin qershor ka filluar edhe Programi i Pagesave Direkte. Drejtoria ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit, duke rritur numrin e stafit me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të shpejta dhe efikase për fermerët. Afati i aplikimit përfundon më 22 korrik, ndërsa pritet të aplikojnë rreth 1,700 fermerë.

Të gjitha lëndët e fermerëve që kanë aplikuar për subvencionimin e qumështit janë shqyrtuar, janë miratuar edhe nga Kuvendi Komunal dhe, pas përfundimit të procedurave të ligjshmërisë, pritet të procedohen menjëherë për ekzekutimin e pagesave.

Gjatë muajit qershor, Drejtoria ka pranuar kërkesa nga qytetarët për trajtimin e qenve endacakë dhe ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në terren për adresimin e këtyre rasteve.

Po ashtu, janë realizuar vizita në terren për të parë nga afër punën e fermerëve dhe përgatitjet e tyre për fillimin e sezonit të korrje-shirjeve.

Me ftesë të organizatës Four Paws, përfaqësues të Drejtorisë morën pjesë në një punëtori dyditore me temë zvogëlimin, trajtimin dhe menaxhimin e qenve endacakë, me qëllim të shkëmbimit të praktikave dhe përvojave në këtë fushë.

Janë realizuar vizita në terren për të parë nga afër punën e fermerëve dhe përgatitjet që ata po bëjnë për fillimin e fushatës së korrje-shirjeve. Pritet që fushata të fillojë në ditët e para të muajit korrik.

Gjithashtu, jemi në pritje të rekomandimeve nga Ministria e Bujqësisë lidhur me çmimin orientues për hektar, si dhe udhëzimeve të tjera për organizimin e fushatës. Drejtoria do të veprojë në përputhje me rekomandimet e Ministrisë dhe legjislacionin në fuqi, me qëllim që fushata e korrje-shirjeve të zhvillohet në mënyrë sa më të rregullt, efikase dhe të suksesshme.